



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:143076

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05859014

Ac.nr. 6327/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Lumni Sallauka e Liridon Maloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. Sh nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H. S avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për kompensimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2318/2022 të datës 10.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si e bazuar, ankesa e paditëses N. Sh nga Prizreni, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2318/2022 i datës 10.08.2022, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I, të dispozitivit Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditëses N. Sh nga Prizreni me numër C.nr.2318/22 të dates 14.07.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, lidhur me çështjen juridike për kompensim të pagave përcjellëse në pension dhe shpërblim jubilar. Në pikën II, të dispozitivit pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i atakuar apo i njëjti të ndryshohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore, me arsyetim se çështja e cila është objekt i saj në rastin konkret përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen lidhur me këtë çështje juridike është kompetent Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e kjo për faktin se e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune në shërbim civil –referente në zyrën e pritjes në kuadër të Drejtorisë për shërbime Publike.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktvendimin e gjykatës shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1: “Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mund të ketë ndikim në nxjerrjen e aktvendimit të ligjshëm e të drejtë”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:c) t’a prishë aktgjykimin e goditur dhe t’a kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.

Neni 209 pika d) i LPK-së: “Duke vendosur për ankimin e veçantë, gjykata e shkallës së dytë mund:.....d) të aprovoj ankesën dhe të anulojë aktvendimin e goditur, e kur është nevoja ta kthejë çështjen në procedim të serishëm”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, nuk e miraton Gjykata e Apelit e Kosovës. Kjo pasi që kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Në nenin 20 të Ligjit për Gjykatat është parashikuar që: *"Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet përveç nëse kjo është në kompetencë të një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore"*. Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson, se kërkesëpadia e paditëses ka të bëjë me kompensimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Sipas Ligjit Nr.6/L-054 për Gjykata, përkatësisht me nenin 17 paragrafi 1, përcaktohet se: *"Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj"*.

Në nenin 13 të Ligjit për konflikti administrativ është parashikuar: *"1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Ndërsa në nenin 14 është parashikuar që: "Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj"*. Kolegji civil i Gjykatës së Apelit, vlerëson se, çështja e ngritur me padi nuk bie në asnjërën nga këto kushte ligjore që i ka paraparë Ligji për konfliktin administrativ. Për më tepër, kolegji gjen se në rastin konkret bëhet fjalë, për një rast kontestimor, i cili bazueshmërinë e ka në të drejtat që burojnë nga kontratat kolektive, ndërsa këto kontrata kolektive bazën ligjore e kanë në Ligjin e Punës. Për arsyet e theksuara, kolegji gjen se, në çështjen e ngritur sipas padisë së paditëses, kompetenca lëndore bie në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, prandaj edhe kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse, dhe ka vendosur që aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në ri procedim në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurë të serishme gjykata e shkallës së parë, duhet që të vazhdoj me procedimin e çështjes dhe pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike e me aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par. 1 pika c) dhe 209 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6327/2022, me datë 25.06.2024

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj